



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-010/04-18203/23, më 25 JAN 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe përzgjedhjen e përfituesve sipas thirrjes publike-dhurimi i mjeteve bujqësore për familjet në kushte jo të favorshme socio - ekonomike.
- II. Anëtarët e komisionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 1. Merita Tolaj, kryesuese, Drejtorja e Bujqësisë;
 2. Valbona Kasabaqi, anëtare, Qendra për Punë Sociale;
 3. Blerim Arifi, anëtar, Fondacioni "Amaneti";
 4. Leonora Sadiku Tupalla, anëtare, Sektori Ligjor;
 5. Mejreme Selimi, anëtare, Drejtorja e Mirëqenies Sociale.
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi është shqyrtimi i kërkesave dhe përzgjedhja e përfituesve sipas thirrjes publike-dhurimi i mjeteve bujqësore për familjet në kushte jo të favorshme socio - ekonomike.
- IV. Për kryerjen e detyrës si në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

